



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3, datë 25.02.2025

I mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”, mbledhje e radhës.(Ora 10:20)

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Simo Petromilo | 20.Ervis Moçka |
| 2.Myzafer Elezi | 21.Sokol Kushta |
| 3.Vullnet Bilbilaj | 22.Eglantina Aliaj |
| 4.Rajmonda Zoto | 23.Ardian Musta |
| 5.Roland Strakosha | 24.Englantina Imeraj |
| 6.Edison Kapaj | 25.Dikens Bushaj |
| 7.Klodian Xhyheri | 26.Vjola Xhafaj |
| 8.Arsen Belaj | 27.Grigor Dede |
| 9.Anxhela Shenaj | 28.Jerina Dervishaj |
| 10.Brikena Puka | 29.Ledja Shollaj |
| 11.Liri Dëma | 30.Illir Aliaj |
| 12.Brikena Sika | 31.Atird Hoxha |
| 13.Lorel Canaj | 32.Geron Gunbardhi |
| 14.Liljana Breshani | 33.Besmir Brahimi |
| 15.Gjergji Nika | 34.Elca Bezhani |
| 16.Evis Allushi | 35.Briseida Çakërri |
| 17.Endri Hyseni | 36.Aurora Qarri |
| 18.Bujar Osmënaj | 37.Eda Begaj |
| 19.Simbol Pazaj | 38.Edlira Kapllanaj |

Mungojnë :

- 1.Elpiniqui Mërkuri

- 2.Novrus Rrokaj
- 3.Gëzim Çapoj
- 4.Shkëlqim Leskaj
- 5.Frosina Qyrdeti
- 6.Anisa Ceno
- 7.Marsela Dashi
- 8.Eneida Vera
- 9.Alta Haluci
- 10.Erëmal Arapi
- 11.Arjan Isufaj
- 12.Refie Laze
- 13.Mujo Shakaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/1, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Meqënëse kuorumi është i plotësuar, vazhdojmë me rendin e ditës.

Z.Klodian Xhyheri – Që nga seanca e kaluar, ku kemi diskutuar problematika të qytetarëve në pikën “Të ndryshme”, e kemi në fund të rendit të ditës. Herën e kaluar administrata dhe pjesa më e shumtë e këshilltarëve nuk ishin prezentë, kështu që mendoj, pika “Të ndryshme” të kalojë në fillim.

Z.Atird Hoxha – Për procedurë. Është një grup qytetarësh nga Tragjasi, kanë problemin e vendburimit...Këta nuk furnizohen dot me ujë, ndërkohë që kryetari i bashkisë, ka nxjerrë një leje infrastrukture. Duhet të kemi një qëndrim të unifikuar. Mendoj që kjo është çështja më kryesore, po u rrezikohet jeta këtyre qytetarëve, po ngelen pa ujë.. Janë të gjithë të unifikuarNe të jemi të unifikuar, të mbajmë një qëndrim, mos t’ju hiqet uji.

Z.Gjergji Nika – Në 31 janar është lëshuar një leje infrastrukture..Kjo leje ka gabime ligjore..Kjo leje është abuzuese.

Z.Ervis Moçka – Thoni për procedurë dhe bëni politikë. Nëse kanë një shqetësim.., qoftë dhe shqetësimi i një banori, është shqetësim i të gjithëve. Po duan ta diskutojnë, ta dëgjojmë dhe shqetësimin e qytetarëve. Të kishte një përfaqësi të tyre, ose dhe nga kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak. Kryetari i bashkisë, nuk është. Duan të takojnë kryetarin e bashkisë, të kenë një përfaqësi..Po.

Z.Atird Hoxha – Nuk e kam politike, por të marrësh ujin nga bashkia juaj...shikojni kanë nevojë, po ju vjedh ujin, jetën, shteti.

Banor i Tragjasit – Nuk erdhëm për politikë, kemi ardhur të zgjidhim problemin. Kryetari i bashkisë ka dhënë një leje ndërtimi, pa na thënë. Është e padrejtë, mos e hidhni në politikë.

Z.Myzafer Elezi – Ne nuk kemi dijeni për këtë problem. Është shqetësim i qytetarëve, nuk jemi kompetentë për këtë problem.

Znj.Irena Toshkallari – Në lidhje me këtë problematikë, kryetari i bashkisë, ka thirrur nesër një mbledhje me përfaqësues nga AKUMI, qytetarë, administrata dhe një grup këshilltarësh.

Nesër do diskutohet për problemin tuaj, duhet të vijë përfaqësuesi nga AKUK-u. Shqetësimi juaj është dhe shqetësim i kryetarit të bashkisë, prandaj ka thërritur kryetari i bashkisë strukturat përgjegjëse për të diskutuar për këtë , për lejen ..

Z.Ervis Moçka – Zotërinj qytetarë, kur bëhet një protestë..kur institucionet nuk kanë vëmendje. Ju sot sensibilizoni dhe këshillin, dhe kryetarin. E arritët qëllimin .Kemi përfaqësues nga AKUK, institucionet vendimmarrëse, ku të diskutohen të gjitha problematikat dhe për zgjidhje..

Kryetari i fshatit Tragjas – A përfaqësoni popullin ? Kemi dy muaj me këtë problem.

Z.Klodian Xhyheri – Jo të flasim pasi kemi nënshkruar shkresat . Bëje më përpara, nuk mund të fshiheni, ju mos bëni politikë. Ne si opozitë nuk do të ndalemi për këtë problem.

Z.Arsen Belaj – Si përfaqësues i asaj zone, do marrë shumë seriozisht se është problem i gjithë krahinës. Janë dhe shumë resorte..Kjo procedurë është bërë pa konsultuar me popullin. Secili këshilltar ta kthejë shqetësimin nga vetja.

Zonja nënkryetare, kur do bëhet ky takim ..Mbledhja të bëhet në fshatin Tragjas, ora dhe dita.

Z.Myzafer Elezi – Jam me ju, mbështes qytetarët. Në emër të këshilltarëve 5 minuta pushim.

Znj.Rajmonda Zoto – Edhe në lidhje me problemin e devijimit të ujit, nuk jam dakort. Në këtë iniciativë që keni marrë, ju mbështes.

Znj.Irena Toshkallari – Ditën e enjte, ora 12:00 në fshatin Tragjas, do bëhet takimi. Do jenë prezentë Kryetari i bashkisë dhe drejtuesit e institucioneve.

Z.Myzafer Elezi – Faleminderit, do të takoheni ditën e enjte , ora 12:00 në fshatin Tragjas.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Znj.Irena Toshkallari – Për pikën “Të ndryshme “ do jenë gjithë drejtorët deri në fund të mbledhjes.

Z.Myzafer Elezi – Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 18 dhe 27 Dhjetor 2024.

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohen.

-Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28 Janar 2025.

Pro – 31 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Vazhdojmë me shprehjen e ligjshmërisë, për VKB e mbledhjes së datës 28.01.2025;

VKB Nr 4 – 12 , janë shprehur me karakter individual dhe të ligjshëm nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë. (Lexon shkresën e ardhur nga prefekti)

Vijojmë me rendin e ditës.

Z.Gjergji Nika – Për procedurë. Në mbledhjen e kaluar , kemi qenë një grup që kemi diskutuar

tek pika “Të ndryshme “. S’ka pas asnjë nga drejtorët e administratës. Detyrat e lëna, është mirë që të bëhen, të reagojnë.

A do na japë ndonjëri sqarim? Na thoni si do veprojmë, se drejtorët nuk ishin prezentë .

Z.Daut Zëraj – Në lidhje me informacionin për këto pyetje, s’ka ardhur ndonjë me shkrim, por janë të gjithë prezentë për të dhënë sqarimet.

Z.Gjergji Nika – Nëqoftëse mungon ndonjë nga drejtorët , të njoftohet dhe të vijë deri në fund të mbledhjes.

Z.Myzafer Elezi- Nga kryetari i bashkisë ka ardhur një shkresë me shtesë dy projektvendime , ku kaluan në mbledhjet e komisioneve , “Për ngritjen e qendrës së të moshuarve..” dhe për dhënie titulli “Qytetar Nderi i Vlorës “

Z.Gjergji Nika – Në lidhje me projektvendimin, për dhënie titulli “Qytetar Nderi “ a është dokumenti që s’ka pas lidhje me sigurimin e shtetit.

Z.Myzafer Elezi – Hedhim në votim rendin e ditës që kaluam në kryesi , plus pikën 1 që e kaluam në komisione.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Z.Endri Hyseni – Për procedurë , nuk mund të diskutohet një projektvendim pa vendosur, do hyjë apo jo në rendin e ditës.

Z.Klodian Xhyheri – Jemi në rregull me rregulloren ?

Z.Myzafer Elezi – Me pikën 1 jemi në rregull.

Z.Ervis Moçka – Është mirë që të mblidhen kryetarët e grupeve në lidhje me projektvendimin , për dhënien e titullit, “Qytetar Nderi” që të miratohet nga të gjithë.

Z.Myzafer Elezi – Kryetarët e grupeve,5 minuta të mblidhen për të diskutuar pikën e dytë , projektvendimin për dhënien e titullit , nga kryetari i bashkisë.
(Mblidhen kryetarët e grupeve).

-Lidhur me dy propozimet për projektvendimet shtesë nga administrata e bashkisë, kryesia vendosi ti kalojë .

Z.Ervis Moçka – Siç e citova , ka një praktikë në këshill, kur vjen një dosje për titull nderi , votohet nga të gjithë pa debat.

Edhe ky projektvendim, edhe pse s’ka kaluar në kryesi , detyrë për sekretarin në lidhje me projektvendime të tilla, për tituj nderi, kërkoj të jetë kusht , të jetë rasti i fundit ky që, është jashtë procedure.

Z.Myzafer Elezi – Hedhim në miratim shtesën, pikën e dytë të ardhur nga administrata.
Votohet.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota
Abstenim – 0 vota.
Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 3/2, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Pika 1 e rendit të ditës, projektvendimi ”Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar 2025”.

Pikat 1 dhe 2 projektvendime të ndihmës ekonomike. E kalojmë në votim ?

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 3/3, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi ”Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2025”.

Votohet.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 3/4, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve me probleme të thella social – ekonomike , që do të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë , për një periudhë 12 mujore me të ardhurat e bashkisë “.

Znj.Irena Stasa – Si çdo vit, ky projektvendim bëhet një herë në vit . Janë fëmijë nga familje me probleme të thella social – ekonomike. Kështu , përfitojnë 20 fëmijë në kopshte dhe 3 fëmijë në çerdhe , të trajtohen 12 muaj të vitit me ushqim falas.

Z.Myzafer Elezi – Diskutime ? -Jo.

Votohet.

Pro - 29 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KESHILLI I BASHKISE**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/5, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 111, datë 27.12.2024 “Për buxhetin e bashkisë për vitin 2025 “.

Z.Kozma Mali – Bazuar në Ligjin Nr 9936/2008 , që rregullon sistemin buxhetor., mbi zbatimin e Aktit Normativ dhe VKB Nr 111 datë 27.12.2024, administrata ka hartuar projektvendimin . Bashkia Vlorë aplikoi në Ministrinë e Bujqësisë, me Aktin Normativ 5 datë 19.12.2024 dhe fitoi projektin.

-Shpenzime – 29 milion , nga këto 40mijë , për këtë treg, për rivitalizimin e këtij tregu.

Z.Gjergji Nika – Nga zyra e urbanistikës, në komisionin e financës , kemi parë dhe projektin. Zoti sekretar, pse s’na ka ardhur projekti?Fondin e kaluam, por bashkëlidhur duhet dhe projekti, të shohim këto fonde ku do shkojnë.

Znj.Elca Bezhani – Në mbledhjen e komisionit, projekti erdhi, të gjithë e pamë. Në muajin nëntor Bashkia Vlorë ka aplikuar dhe ka fituar, projektin për rivitalizimin e e tregut, për paraqitjen sa më dinjitoze të produkteve të tyre. Fondi është akorduar në muajin dhjetor, paratë transferohen nga viti i kaluar. Projektvendimi erdhi i detajuar. Çdo gjë ishte e saktë. Nëse këshilltarët e tjerë duan të njihen me projektin..

Z.Klaudio Mehmeti – Rivitalizimi i tregjeve , është projekti që po prezantojmë, është hartua nga Drejtoria e urbanistikës dhe aplikuar nga Bashkia Vlorë, me një fond rreth 30 mijë lekë, nga Ministria e Bujqësisë. Projekti shtrihet që prej shkallëve , në zonën e asfaltit të makinave , nuk pengon familjet dhe kryqëzohet me rrugën “Veledin Kollozi “, nuk prek as trotuarë dhe as biznese.

Qëllimi, objektivat lexon...

-S’ka ndikim në mjedis , ka një gjatësi 30 m..

Ndikimi mjedisor..lexon..

-Rreth 20 struktura të çmontueshme, me ndriçim, ujësjellës, kanalizime.

-Planvendosja e të gjithë projektit plus pjesën mbuluese me panel diellor.

-Pamje , si do shtrihet gjithë projekti ..

-Pjesa e trotuarit nuk çënohet. Është pjesa nga bulevardi, sepse është treg tradicional, tu jepet akses dhe turistëve që të kthehen përgjatë bulevardit.

Në mbledhjen e komisionit të financës , u diskutua në lidhje me tregjet.

Fakti që me FSHZH po zhvillohet projekti për tregun e madh të qytetit tek “Sahati “.

Z.Atird Hoxha – Një pyetje. Nuk jemi kundër investimeve ..210m2 me materiale të riciklueshme..them që këto shifra i tejkalojnë .., mendoj që është shifër shumë e madhe. Mendoj që nuk i jep një zgjidhje zonës, për një sipërfaqe kas të vogël. Mendoj që, mund të investohet në një vend tjetër. Duke implementuar këtë projekt , do ketë më shumë problem dhe për qytetarët dhe bizneset e tyre, por dhe për trafikun, do bllokohej më shumë. Nëqoftëse, ky projekt do të shkojë deri në fund të rrugës, do të shkojë investimi deri në 300milion. Do ishte e udhës që ti jepej frymë dhe biznesit dhe trafikut. Është lënë në harresë ajo zonë.

Z.Klaudio Mehmeti – I jepet akses turistëve..Nuk çënohet akses i lagjes.

Pjesa atjetër , është çështje teknike . Çdo inxhinier ka përpiluar pjesën e vet. Është bërë preventivi. Kjo është thirrje nga ministria.

Z.Atird Hoxha – Është e ekzagjuar.

Z.Simbol Pazaj – Deri aty ku është projekti ? Po më tej ? Deri tek ajo fazë jemi dakort.

Z.Gjergji Nika – Pozicioni që kanë zgjedhur, pavarësisht trashëgimisë, në komision thashë , gjeni një vend tjetër. Unë do isha që të rishikohej pozicioni. Po bëhen 20 poste, ka më shumë tregëtarë, ose bëjeni tamam ose ndryshojeni.

Znj.Elca Bezhani – Kur e diskutuam rivitalizimin e këtij tregu , drejtoresha e turizmit, tha, kjo pjesë do t’ju shërbejë artizanëve të tregut. Është menduar nga ana e bashkisë , ndërtimi i këtyre vendeve. Dhe do vazhdojë hap pas hapi. Është problem pjesa që ngelet pas dhe lamë detyrë për tregëtarët e tjerë që, mos të jetë treg me aromëra të këqija. Të tregohet që, përveç pjesës së bukur që do krijoni , të tregohen vendet dhe për tregëtarët e tjerë.

Z.Sokol Kushta – Në lidhje me tregun, ishin rreth 30 tregëtarë dhe rreth 6000 banorë . U la të hiqej ai treg...Ky treg është i bukur „por unë mbështes, a do jetë funksional , se mos nga artizanë, na kalojnë në fruta perime. Prandaj, them që, gjatë investimit që do bëhet të mendohen lehtësira nëpër lagje.

Dy anët ne i hoqëm , treg dinjitoz me tezga del..Meqenëse dëgjova vazhdimësinë , mos na prishet më vonë..., ka shumë banorë në atë zonë. U jepni një dinjitet atyre njerëzve.

Z.Myzafer Elezi – Diskutim tjetër ?

-Jo.

E hedhim në votim.

Pro – 29 vota

Kundër – 2 vota

Abstenim – 2.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KESHILLI I BASHKISE**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/6, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi - Kalojmë tek pika 5 e rendit të ditës, Raporti i Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për Vitin 2024 dhe projektvendimi “Për miratimin e Buxhetit Faktik të vitit 2024”.

Z.Kozma Mali – Projektvendimi është një analizë e plotë e realizimeve të Bashkisë Vlorë për vitin 2024.

-Nga të ardhurat e veta -1milion 411...ose 75% të planit të miratuar.

- Për shkak të disa treguesve në nivele të ulëta , si të ardhurat nga qiratë 1%; taksa e ndikimit në infrastukturë 55%; lexon tarifat ...të ardhurat nga granti i pakushtëzuar ...

-të ardhurat nga shpenzimet-1.033.113 mijë lekë ose 70%

-Detyrime të palikujduara, janë shlyer në masën 38 milion 612 mijë

-Shuma e detyrimeve – 6 milion 179 ..., për mungesë dokumentacioni këto janë detyrime të palikujduara. Ka mos realizime ...

-Nga granti specifik nuk u realizuan investimet , vlera 41,603 mijë lekë...

Nga sa më lartë , kërkojmë miratimin nga këshilli bashkiak . Për fondet që nuk u përdorën për vitin 2024, nga administrata do vijë projektvendim tjetër.

Z.Gjergji Nika – Drejtorët përkatës që nuk kanë realizuar të ardhurat , si nga qiratë 1% etj...të diskutojnë .

Z.Ervis Moçka – Kush është pyetja ?

Z.Kozma Mali – Taksa e ndikimit në infrastrukturë , 55% për shkak të zbardhjes së lejeve të ndërtimit, që do të zbardhen këtë vit.

Z.Gjergji Nika – Pse është 1% realizimi nga taksa e qirasë ?

Znj.Elca Bezhani – Raporti i monitorimit për vitin 2024, është një raport analizë i të gjitha drejtorive të administratës. Në komisionin e ekonomisë, përveç anëtarëve të komisionit, ishin prezentë dhe drejtorët .

- U diskutua për informacionin nga Drejtoria e Tatim Taksave , në lidhje me subjektet për çrregjistrim, pezullim dhe riaktivizim të subjekteve.

Gjatë diskutimeve që u bënë, u kërkuar informacion dhe për borxhin , që është prezantuar në 1 janar.

Duke krahasuar vlerën, nga administrata me atë çkishim plan dhe atë që kanë vjelë.

Administrata për vitin 2024 të mbledhë një pjesë të borxhit.

Pse në disa zëra kemi vlera të ulëta, vjelje të të ardhurave...

-Siç u tha nga drejtori i financës , taksa e ndikimit në infrastrukturë 55%, është e ulët , pasi në planifikimin e administratës, këto do të ktheheshin në shpenzime për investime.

-Taksa e tabelës – 40%.

Nëqoftëse, ka mosrealizime, lihen detyra, kështu që u lihet detyrë administratorëve të njësive në lidhje me këto taksa, taksën e tokës bujqësore.

-U diskutuan dhe lejet e dhëna në zyrën e urbanistikës . Zoti Nika, kërkoi një listë me numra, sa leje janë dhënë.

Nëqoftëse, drejtorët kanë diçka për të shtuar për pjesën e detyrave...

Znj.Irena Toshkallari – Administratorët e kanë sjellë në drejtorinë juridike informacionin në lidhje me taksën e tokës bujqësore..Kush nuk paguan taksën e tokës bujqësore , do kalojnë dhe deri në prishje të kontratës.

Z.Gjergji Nika – Toka 1%, ujitja “0” zero.

Znj.Irena Toshkallari – Për pjesën e parë, ju thashë , për procedurën që është ndërmarrë, ndërsa për ujitjen do të marr informacion.

Z.Atird Hoxha – Kur kemi diskutuar projekt buxhetin e ri, projeksioni që kishte planifikuar Bashkia Vlorë ..., të ardhurat 75%..Ose janë të paaftë në realizim , ose në planifikim. Flasin shifrat.

Realizimi mujor 2024 dhe të mungojnë mbi 4milion euro ...,këto janë lekë në arkën e bashkisë dhe nnë investimet për qytetarët. Duke mos i realizuar juve këto, do ketë mangësi për qytetarët . Tek shifrat nuk shoh pritshmëritë në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë. Asgjë reale për qytetarët.

-Për njësitë administrative , fshati Bishan pseudo investim në ujësjellës, probleme me ujin.

-Fshati Fitore, problem kanali i ujrave të zeza

-Fshati Trevllazër, mungon uji i pijshëm. Problem dhe vaditja, nuk ekziston.

-Problemi në fshatin Tragjas që duhet të na mbledhë të gjithë. Është problem jetik uji i pijshëm. Të gjithë paguajnë taksën. Është një gjë që duhet të na shqetësojë të gjithëve si dhe fshatin Radhimë, Njësinë Orikum etj, që janë harruar në kët buxhet. Janë të shumta problematikat dhe për vitin 2025keni planifikuar shifra të larta. Realizimi i këtyre të ardhurave cënon qytetarët. Problem tjetër dhe çarja e rrugëve, me pretendimin që do përmirësohen , problemi i ujit të pijshëm.

Z.Geron Gunbardhi – Për 1% taksën e tokës bujqësore., problem i mbartur në vite. KLSH-ja ka lënë detyrë, prishjen e kontratave.

-Për problemin e vaditjes, më parë të pastrohen kanalet.

-Borxhi i Ujësjellësit , në arkën e bashkisë , çfarë është mbledhur ? Ku kanë vajtur 2,3 milion euro. Të na thonë, çfarë është bërë.

Z.Grigor Dede – Një pjesë të shqetësimeve e dëgjoi administrata, për pjesën e borxhit të Ujësjellësit , di që është bërë një marrëveshje me Sh.A.Ujësjellësin dhe Bashkinë Vlorë, për shlyerjen e borxhit. Është një debi e mbartur në vite, por borxhi nuk ulet menjëherë. -Kemi për diskutim raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. Pjesa e realizimit të të ardhurave 75%..Këtu një impakt ka taksa e ndikimit në infrastrukturë, parashikimi nga drejtoria , 5 milion euro.

Kjo varet nga zbardhja e lejeve. Ka leje që nuk janë zbardhur ende.

Ka vite që, kjo vlerë parashikohet dhe nuk realizohet. Po të ishte raelizuar kjo taksë, do ishte në 87-88% të realizimit të buxhetit.

-Taksa e tokës bujqësore , duhet tu tërheqim vëmendje njësive dhe administratës për të gjetur një mekanizëm të ri, për vjeljen e kësaj takse.

-Shpenzimet mund të ishin bërë dhe më mirë , por kjo do ishte bërë më mirë nëqoftëse do ishin realizuar më shumë të ardhurat.

Z.Illir Aliaj – Këtu ka planifikim dhe realizim. Për taksën e ndikimit në infrastrukturë, ka shumë kërkesa për ndërtime dhe, kjo vlerë nuk është mbledhur për mosrealizimin e kësaj takse, drejtori shpjegoi.

Znj.Edlira Kapllanaj – Disa rekomandime:

-Shtimi i transparencës

-Analizë krahasuese ndër vite

-Përfshirja e grafikëve

-Rishikimi periodik i buxhetit .

Znj.Elca Bezhani – Në përgjigje të koleges, për të qenë më i qartë raporti. Ne i lexojmë dhe analizojmë projektvendimet , kur ekmi paqartësi e kemi derën e hapur nga administrata. Lidhur me krahasueshmësinë nga viti në vit, i kemi.

Z.Ervis Moçka – Është një nga dokumentat më të rëndësishëm raporti i monitorimit. Është një raport analize nga çdo drejtori. Jo vetëm arritjet, por dhe problematikat dhe si do ti rregullojmë.

-Përsa i përket raport analizës, do ishte mirë të përqëndroheshim tek problematikat që ti vëmë para përgjegjësishë .

-Tek të ardhurat nga qiratë , 1% jo vetëm nga njësitë ..Nëqoftëse, duam të analizojmë kush është problemi , kemi këtu jo vetëm dhënien e kullotave, por dhe të godinave etj.. me vlerën 1%. Pse mos të paguajnë dhe këto qira ? Pra jo vetëm kullotat..

-Pse kanë realizimet dhe diku, mbi planin ?

Do të ishte mirë, të planifikohej mirë. Mosrealizimin e kthyen në paaftësi ...

Pra, janë dhënë lejet , janë llogaritur, por nuk janë miratuar..Pra, janë arsye objektive dhe subjektive.

-90% biznesi mbi pasurinë e paluajtëshme

-110% për ndriçimin, pastrimin,,

Agjenti tatimor i mbledh këto taksa dhe çfarë bëhet...Do ndaloja pak dhe në drejtoritë e tjera.

-Drejtoria e urbanistikës, me lejet, zbardhjet në planifikim..

Do evidentuar nga drejtoria e urbanistikës ...po të shikosh në faqen 43., kemi gjithë projektet , fazat e realizmit, janë plot 55 të realizuara.

Duhet të gjejmë problematikat. Drejtoria e urbanistikës ka planifikuar..., ka realizuar 55 objekte, por ka realizuar dhe 1PDV, i cili është zhvillimi i teritorrit. A ka mundësi që herë tjetër, të vini me më shumë PDV?

-Drejtoria e Pronave publike dhe menaxhimit të aseteve, ka sektorin e AZMT, e cila ndihmon qytetarët që nga AMTPërdorim , ti kthjeë në pronësi..

Janë 696 dosje ...Sa janë ndjekur nga këto..Janë dërguar në ASHK , 696 janë pasuri , është bllokim ekonomie dhe marrin shumë pak nga ASHK. Pra, ky është problemi. Janë 1026 dosje akoma. Është pasuri , janë taksa të pambledhura.

Pra, çfarë do bëjmë për këtë ?

-Për disa zona , prona shtet..Janë 874 të evidentuara dhe të rregjistruara 24.Ky është planifikimi. Që mos të ndodhin problematikat , pse ky apo ky person, mos të kemi amendësime . Të 874 na i sillni.

-Do të vazhdoja me 1065 ndërhyrje të zjarrfikëses..Pra, si të parashikohet, çfarë ju duhet ?....

-Tek parkimet..Do bërë kërkesë, që të gjithë vitin tjetër, për raportin e monitorimit të parashtrihen problematikat dhe kërkesat .

Drejtorët ta shohin si përgjegjësi dhe të sjellin propozime konkrete, dhe këshilltarët ta lexojnë dhe analizën.

Z.Myzafer Elezi – Jam drejtuesi i seancës , jo në të opozitës. Fjalën e ka marrë gjithkush që ka kërkuar.

Z.Gjergji Nika – Nuk i heq asnjë fjalë zotit Moçka .

Drejtoria e tatim taksave

-365 subjekte çrregjistrim

-327 subjekte pezullim

-154 subjekte riaktivizim...

Në buxhet, zëri paga ...Bashkia të ardhurat i vë për pagat ,18 milion euro për pagat dhe 4 milion euro investime..

Përsa i përket realizimit në njësitë administrative...janë pensionistë.

Pra, taksa 1% nga qiratë, do jëtë më e ulët kjo taksë 0,5.

-Ata të zjarrfikëses, 100 ndërhyrje , zjarre..Drejtori ka shkruar për blerje makinash, uniformash etj..Zjarrfikësja i ka kërkuar , nuk ia japin . Nëqoftëse, do ti referohemi raportit , drejtoria e shërbimeve 850 aplikime

-Kanalet pa pastruar..si nga Ministria e Mbrojtjes apo si në raportin 8-mujor.

-Landfilli , ka përfunduar 95% të punimeve . Kryetari ka thënë që, brenda muajit shkurt shpresojmë të fillojë Landfilli. Nuk mbahen fjalët.

Bashkia duhet të kalojë në një reformë.

Znj.Elca Bezhani – Në lidhje me tabelën e drejtorisë së tatim taksave . Ajo tabelë përmbledh subjektet , 846 , pra që nuk mund të operojnë vetëm këto, i lexon si do zoti Nika

-365 subjekte për çrregjistrim

-327 për pezullim, kanë karakter sezonal, dhe në momentin që u vjen sezoni , 154 subjekte riaktivizohen.

Me shifrat mos të lozim.

$846 = (365+327+154)$

Tabela e të ardhurave nga qiratë , nga mjetet , toka, godinat, nuk ka lidhje domosdoshmërisht me njësitë administrative.

Taksa e tokës bujqësore -40%, kjo ka lidhje me njësitë administrative, të cilat të gjejnë mekanizmin për vjeljen e kësaj takse.

Z.Gjergji Nika – Pjesa e pezullimeve dhe të riaktivizuara , 50% më pak. Ai që fillon ..

Z.Ervis Moçka – Në një raport monitorimi , mos të përdorim politikë , shifrat do si i lexon. 174% realizimi ...dhe 74% tejkaluar taksa e fjetjes në hotel. Rritje me 47%.

Është qyteti turistik numër 1 në shqipëri, falë politikave dhe investimeve.

Z.Gjergji Nika – Pse ka ndodhur realizimi i kësaj takse , sepse janë 150 ditë full dhe është rritur me 20milion lekë/reja, lexon pozitivitet, dhe jo 4 milion euro investime.

Z.Klodian Xhyheri – Si do jesh numri 1, me djegien e plehrave .., jemi pa ujë.

Z.Geron Gunbardhi – Ato që tha zoti Moçka në analizë ..,dhe ne drejtorët po kërkonim. Nga mbledhja në mbledhje nuk kemi një përditësim. Me të gjithë analizën që bëri zoti Moçka jam dakort , janë të gjitha të vërteta .

Z.Gjergji Nika – Gjithë situata është që, administrata mos të kthejë përgjigje ...Kërkuam drejtorin juridik në lidhje me borxhin.

Znj.Irena Toshkallari – Kërkuam fjalën për sqarim , drejtori juridik për borxhin .

Z.Myzafer Elezi -Në fund doni drejtorët për raportimin, për pikën “Të ndryshme “

Z.Dorian Demiri – Përsa i përket borxhit për vitin 2024, Ujësjetësi po i bën pagesat muaj për muaj.

U diskutua dhe ecuria me niptin e vjetër , e kemi formalizuar si borxh.

191 milion , prinçipali

263 milion borxhi. I është dërguar kërkesë ujësjetësit . Do mblidhet Bordi për të parë termat e marrëveshjes dhe, për të përcaktuar një vlerë për marrëveshjen .

Z.Ilir Aliaj – Po të shohim dhe pagesën e energjisë , ka rrit performancën.

Z.Myzafer Elezi – E hedhim në votim.

Pro – 29 vota

Kundër – 5 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/7, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Tavanëve Përgatitorë për të Ardhurat për 2026-2028”.

Z.Kozma Mali – Projektvendimi është një ndër aktet që i paraqitet këshillit për PBA 2026 – 2028. Bazuar në realizimet për vitet 2023 – 2024...Në vijimësi tavanët nga viti 2023, kanë ardhur në rritje ...Lexon nga viti 2023 – 2028....

Z.Gjergji Nika – Për vitin 2024, nga 1 milion 893 ..., janë realizuar 14 milion ..Ju thoni, nga 14 do shkoni , për vitin 2028 në 23 .

Z.Kozma Mali – Ky është një projeksion që priten të zbardhen lejet nga drejtoria e urbanistikës. Jemi të detyruar ta planifikojmë.

Z.Myzafer Elezi – Diskutime ? – Jo
Kalojmë në votim.
Pro – 26 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 2 vota
Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/8, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për krijimin e Këshillit Artistiko Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”.

Z.Sokol Kushta – Në mbledhjen e komisionit , ishin 5 emra në këtë këshill.Si procedurë , të jetë më morale. Herë tjetër të vijnë 10 – 15 emra dhe zgjedhim. Kur të vijnë 5 emra , jo se ishim kundra . Ne në komision kërkuam dhe një emër, dhe 2, pra le të jetë me 7 anëtarë këshilli. Është një këshill i detyruar..Për mua, numri i personave herë tjetër, le të diskutohet. Emrin që propozoi zonja Egla.

Znj.Englantina Imeraj – E sqaroi zoti Kushta . Ky është një këshill që do monitorojë dhe institucione të tjera. Ky këshill ka funksionuar , nuk po merrem me emrat. Ky qytet ka shumë vajza dhe djem që tu jepet fjala , do jetë dhe me pagesë.

Emrat z.Vasil Çuni , lexon emrat e anëtarëve të këshillit , janë emra të nderuar. Bëhet fjalë për procedurën, të na sqarojë administrata, pse të vijë me emra të caktuar. Propozim konkret ...ngrihet dhe një problem që mund të rëzohet , por në momentin që na janë diktuar , mos të kalojmë në personale.Emri i gjashtë , propozoj z.Albert Abazaj, Drejtor i Bibliotekës “Nermin Vlora Falaski “.

Z.Daut Zëraj – Problemi është , të diskutohet tek numri, pastaj tek propozimi.

Z.Gjergji Nika – S’jam dakort me zotin Kushta për herë tjetër. Me këto emra shikoj vizionin e Kryetarit të bashkisë. Dëgjova zonjën Imeraj që këto do bashkëpunojnë me institucione të tjera...Si do të munden , ka të datëlindjes 1943. Ka shumë të rinj. Kërkoj të tërhiqet, të vijë në komisione.

Znj.Liljana Breshani – Jam dakort me parafolësit. Vetëm një femër, do doja të kishte përfshirje të grave apo të femrave. Kemi plot në fushën artistike, në fusha të ndryshme të kulturës.

Z.Grigor Dede – Të arrish të diskutosh për një projektvendim për këshillin artistiko – kulturor , duhen artistë me përvojë, eksperiencë pune. Pra, dhe njëfarë moshe. Kanë ardhur në këshill 5 emra , nuk kam gjë me emrat, është bërë publike dhe këtu vjen dhe bëhet politikë me emra të spikatur në fushën e kulturës ,dhe.... para se të vinin në mbledhjen e kryesisë.

Ka ardhur një projektvendim, le të votohet, kush është kundër , kush është pro.

S’më duket normale të diskutohen këto emra. Zakonisht këto projektvendime , kur vijnë në këshill, kalojnë pa debat.

Z.Ervis Moçka – Ka gjithmonë një problem që, kur vjen një projektvendim me emra , ata të diskutohen. Nuk është shumë normale. Ka dhe propozime për të shtuar me 7, me 9 anëtarë. Këto nuk janë projektvendime qokash, por pune. Flas personalisht, ta miratojmë . Meqenëse nga diskutimet e këshilltarëve, administrata ta tërheqë dhe ta risjellë , të shikohet procedura, Është kërkesë e grupit.

Z.Myzafer Elezi – Kush është dakort me propozimin e zotit Moçka, për ta riparë këtë projektvendim ?

Votohet.

Pro – 26 vota

Kundër – 1 votë

Abstenim – 1 votë

Miratohet.

Ky projektvendim të rikthehet tek administrata për të riparë procedurën dhe për ta sjellë në kryesi e komisione për mbledhjen tjetër.

Z.Dorian Demiri – Përsa i përket procedurës nga administrata, është e rregullt. Na thoni , si do vendosim , emra të tjerë apo do na vijnë nga këshilli.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/9, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Pika 8 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Planit Vjetor të Këshillit Bashkiak Vlorë “Për Përmirësimin e Performancës dhe Forcimin e Rolit të Tij “ për vitin 2025.

Kalojmë në votim ?

Votohet.

Pro – 32 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/10, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Para se të shkojmë tek informacioni i punës së këshillit, kalojmë në projektvendimin shtesë “Për Miratimin e Ngritjes së Qendrës Ditore për të Moshuarit”.

Z.Gjergji Nika – Këtu në relacion thuhet 4...lexon 5 punonjës .

Znj.Irena Stasa – Kuzhinierja do bëjë dhe punën e sanitaresh. Do ta bëjmë në vendim, 4 punonjës.

Z.Gjergji Nika – E keni catering , buxhet për 9 muaj.

Znj.Irena Stasa – Po.

Z.Gjergji Nika – 2,6 milion për paga...lexon...totali 2,6 milion pagat, pjestoje ...ju paguani për 11,5 muaj paga ...Të bëhet llogaritja e pagave për 9 muaj dhe e sigurimeve shoqërore . I keni llogaritur gabim 1,7 milion , jo 3,1 . Unë shikoj që ka pjestuar shumën që ke për pagat me pjesën që del 11,5 muaj ..

Znj.Laura Brinja – Është paga për pozicion, vetëm për pozicion, plus vjetërsi, plus diplomë.

Z.Gjergji Nika – Pse s’ma thua për pozicion..70 e ka të përfshirë.

Znj.Laura Brinja – Jo, është paga për pozicion , bruto . 70 plus vjetërsi, plus diplomë.

Znj.Irena Toshkallari – Përmendët disa herë zoti Nika, sepse në destinacion shkojnë 13 milion lekë /vjetra. Këto do shkojnë vetëm për vaktin ushqimor.

Z.Gjergji Nika – Në 1,3 përfshihen dhe aktivitetet.

Znj.Irena Toshkallari – Janë 4milion lekë/vjetra shpenzime operative. Qendra ditore do të ofrojë një sërë shërbimesh multifunksionale nga ora 8-16, aktivitete dhe një vakt ushqimor. Është aplikuar dhe fituar nga Bashkia Vlorë.

Znj.Brikena Puka – Është vetëm për ushqim, jo si burime njerëzore, nuk janë. Pjesa tjetër përkthehet në shërbime, aktivitete.

Z.Ervis Moçka – Drejtuesi i seancës , nuk mund të bëhet debat pa fund , që tu mbushet mendja anëtarëve. Ai e voton kundër ose pro. Është projektvendim, është fond i ardhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe një marrëveshje për 4 burime njerëzore, dhe për të marrë këtë fond hyn bashkia me 10%, dhe në rritje, në vazhdimësi të këtyre projekteve ...

Pastaj diskutojmë, mjafton apo jo. Nëqoftëse dalin me sukses e shtrimë jo me 1, por me 2 qendra ...Ne si grup do ta kalojmë të gjithë . E shohim si shumë të nevojshme.

Znj.Brikena Puka – Lexon..1,3 milion lekë/reja për 7-8 persona në shumën ..., bazuar në VKM.

Znj.Irena Stasa – Është për një vakt, drekën.

Z.Ervis Moçka – Po diskutojmë për 100 të moshuar.., 30 të marrin një vakt, 25 të vetmuar ..Ne jemi dakort ta votojmë si grup, pro.

Znj.Irena Stasa -Janë shkruajtur 4 persona në tabelë, kuzhinierja do bëjë dhe pastrimin.

Z.Myzafer Elezi – Kalojmë në votim.

Pro – 28 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/11, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Kalojmë në pikën e dytë shtesë , në projektvendimin “Për Dhënie Titulli
“Qytetar Nderi i Vlorës” Prof.Dr.Kristaq Kume “.

Votohet.

Pro – 28 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 3/12, datë 25.02.2025

Z.Myzafer Elezi – Pika “Të ndryshme “

Z.Gjergji Nika - Dhe herën e kaluar kam diskutuar për zonën e Skelës , në lidhje me tymrat dhe erëra kuzhine , që qelbet gjithë lagjja. Të vihen disa filtra..Çfarë do bëhet ?

Znj.Elca Bezhani – Herën e kaluar diskutova për një hartëzim në lidhje me pikat e kontenerëve. Sezoni po afron.Do doja një përgjigje..Administrata sot duhet të na kthejë një përgjigje .Znj.Irena Toshkallari – Është ngritur një grup pune për të bërë konstatimet, në lidhje me pikat e vendgrumbullimit të mbetjeve. Do vijmë me një projektvendim në lidhje me këto problematika si dhe shtimin e këtyre pikave.Z.Klodian Xhyheri – Mungesa e ujit në fshatin Nartë dhe Zvërnec. Si do bëhet zgjidhja ? S’kam marrë asnjë përgjigje.

Z.Daut Zëraj – Pyetët për Pallatin Nr 31 dhe zonjën nga fshati Dukat.

Z.Adrian Vreshtazi – Ka qenë zonja Albana Ismaili, ka bërë kërkesë, por jo në bashki. Kemi shkuar për verifikim. Po presim përgjigje nga Instituti i Ndërtimit. Vetëm këtë mund të bëjmë , ekspertizën.

Z.Myzafer Elezi – Kam bërë kërkesë për 2 rrugë në Rajonin Nr 5 . A janë përfshirë në buxhet ?

Z.Zambak Selmani – S’ka fond, ishte mbyllur buxheti , ka ardhur kërkesa vonë.

Z.Myzafer Elezi – A do jënë në buxhetin shtesë ?

Z.Kozma Mali – Do ti shohim, do ti kemi në konsideratë.

Z.Besmir Brahimi – Shqetësim për rrugët e shqyera të qytetit , sezoni turistik po vjen.

-Dua të kthehem tek diskutimi i zotit Moçka . Është një organizatë “Faktoje”, është organizatë realiste dhe ne jemi shumë larg në klasifikim.

-Dua përgjigje për rrugët.

Z.Zambak Selmani – Rrugët kanë filluar të shtrohen. Ka filluar Transballkanikja dhe “Albano & Romina “

Z.Daut Zëraj – Përsa i përket “Faktoje “, çështja e mosrealizimit , përfshiheshin afatet, jo për mosrealizim, por për afatet, s’janë realizuar në afat.

Znj.Rajmonda Zoto – Në 5 Dhjetor 2024 është depozituar kërkesë për pallatin Nr 1289 , ka çarje të mureve etj. A ka shkuar ndonjë grup për verifikim, konstatim ?

Znj.Irena Toshkallari – Do shohim kujt i ka shkuar kjo kërkesë, do shohim çfarë është bërë . Do t’ju kthejmë përgjigje.

Z.Klodian Xhyheri – Për zonën e “Kalasë “, është shumë keq një qytetar live, shqetësim i tij.

-Mungesa e një stacioni interurban. Shifni stacionin interurban.

Znj.Anxhela Shenaj – Kërkesë për serviset që janë nëpër lagje, që zënë gjithë këto hapsira .

S’kemi ku parkojmë.

-Në lidhje me rrugët, “Albano & Romina “, është një gropë e madhe ku mund të bjerë çdo njeri .

Z.Myzafer Elezi – Për tek varrezat publike , janë bllokuar rrugët . Pyetja , për parkimet ?

Znj.Irena Toshkallari – Me Drejtorinë e Policisë Bashkiake , ka nisur një aksion për heqjen e makinave të mbetura .

Z.Myzafer Elezi – Duke qenë se s’keni pyetje të tjera , faleminderit. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.